



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA POGRADEC
KËSHILLI

Nr. 4468/Prot
2

Datë 29.09 2022

VENDIM

NR. 106, DATË 28.09.2022

PËR

**DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË VENDIMIN NR. 41 , DATË 20.04.2022, “ PËR
MIRATIMIN E NIVELIT TË PAGAVE TË PUNONJËSVE TË BASHKISË POGRADEC
DHE NDËRMARRJEVE NË VARËSI”**

Në mbështetje të nenit 54, shkronja “ç”, nenit 55, pika 2, të Ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, ligji nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, I ndryshuar, ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi I Punës I Republikës së Shqipërisë”, I ndryshuar, neni 2, shkronja “c”, Ligjit nr.10405, datë 24.03.2011 “Për kompetencat përcaktimin e pagave dhe të shpërblimeve”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.165, date 02.03.2016 për “Grupimin e njësive të vetëqeverisjes vendore, për efekt page, dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar, të nëpunësve civilë e të punonjësve administrative të njësive të vetëqeverisjes vendore”, indryshuar me vendimin nr.177, datë 08.03.2017 “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr 165, datë 02.03.2016, të Këshillit të Ministrave “Për grupimin e njësive të vetëqeverisjes vendore, për efekt page, dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar, të nëpunësve civilë e të punonjësve administrative të njësive të vetëqeverisjes vendore”, Vkm-së nr. 604, datë 14.09.2022 “Për përcaktimin e pages minimale në shkallë vendi”,

**KËSHILLI BASHKIAK
VENDOSI:**

1. Në Vendimin nr. 41, datë 20.04.2022 “Për miratimin e nivelit të pagave të punonjësve të Bashkisë Pogradec dhe ndërmarrjeve në varësi”, bëhen ndryshimet dhe shtesat si mëposhtë:

2. Paga minimale bruto mujore e punonjësve të Bashkisë Pogradec, Njësive Administrative, Ndërmarrjes së Mirëmbajtjes së Infrastrukturave dhe Punëve Publike, Ndërmarrjes së Parqeve dhe Rekreacionit dhe Qendrës Arsimore të jetë në nivelin **34 000** lekë.

3. Efektet financiare të këtij vendimi fillojnë më datë **01.09.2022**.

4. Vendimii Këshillit Bashkiak nr. 41, datë20.04.2022, **shfuqizohet**.

5. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi Kryetari i Bashkisë, Drejtorja e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse, Drejtorja Ekonomike dhe Menaxhimit Financiar pranë Bashkisë Pogradec, si dhe Ndërmarrjet në varësi të saj.

6. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes publike.

KRYETAR I KËSHILLIT
Sotiraq MANGËRI

